NOTERË TIRANË

# A K T - T H E M E L I M I

Sot me daten 30.05.1996(nentedhjete e gjashtë) ngá ortaka i vetem themelues VLADIMIR METANI me datelindje 1957,lindur në Skrapar dhe banues në Tiranë,me adresë Rruga"Qemal Stafa" Pll. 188/1 me leter njoftimi AZ.Nr.003209,madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar,vendosi të krijojë shoqërinë tregetare me përgjegjësi të kufizuar,në pronësi private të emërtuar"DESARET KOMPANY".

## I DISPOZITA TË PËRGJITHESHME

### NENI 1

Ortaka i vetem krijon Shoqërinë private me përgjegjësi të kufizuar,në pronësi private me mjetet e tij.

### NENI 2

Shoqëria me Përgjegjësi të kufizuar nga neni 1 i ketij akti themelimi do të ushtroj veprimtarinë e saj të përcaktuar në kete akt themelimi me emërtimin "DESARET KOMPANY"SHPK.

### NENI 3

Shoqëria "DESARET KOMPANY"SHPK është person juridik në vehte.Kete te drejtë ajo e fiton me rregjistrimin e saj në Gjykatën e Rrethit Tiranë në Regjistrin tregetar dhe organet financiare.

### NENI 4

Shoqëria Tregetare "DESARET KOMPANY" SHPK do të kete selinë e saj në Tiranë me adresë Rruga"Qemal Stafa",pranë PLL.188/1

Selia e Shoqërisë mund të ndryshojë si adresë.

### NENI 5

Shoqëria Tregetare "DESARET KOMPANY"SHPK ka vlerë dhe interesimin e saj të përcaktuar sipas dëshirës së ortakut të vetem dhe në përputhje me normat ligjore të shtetit.

## II. OBJEKTI I VEPRIMTARISË

### NENI 6

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj:

Ndertime dhe pasime të ndryshme dhea,punime beton arme,shëmbjesh,ndertime civile,industriale,turistike,banjësore, restaurimi,instalime,ujësjellesa,kanalizime,ndertime dhe riparim rrugësh dhe urash,import eksport materiale ndertimi,prodhime materi

%%

ale të ndryshme ndërtimi etj,si dhe prodhim e përpunime druri import-eksport.

NENI 7

Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj të përcaktuar në nenin 6 tëkëtij kontrate,në teritorin e Republikes së Shqipërisë dhe jashtë saj për të realizuar fitim.

Për kryerjen e kesaj veprimtarie shoqëria mund të celë zyra dhe dege në qytete të tjera brenda teritorit të Shqipërisë dhe jashtë saj në përputhje me legjislacionin e saj dhe të vendeve të tjera.

NENI 8

Shoqëria mund të ndryshojë emërtimin si dhe objektin e veprimtarisë së saj vetem me vendim të ortakut të vetem dhe në baze të rregullave të përcaktuara në ligjin"Për Shoqëritë Tregetare".

NENI 9

Shoqëria mund të ndryshojë emërtimin si dhe objektin e veprimtarisë së saj vetem me vendim të ortakut të vetem.

Shoqëria i ka të gjitha autorizimet për qarkullimin juridik me persona të trete.

III. MJETET E SHOQËRISË

NENI 10

Shoqëria vepron në bazë të ligjit,aktit të themelimit, Statutit të saj.

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100000(njëqinte mijë) lekë te derdhur nga ortaku i vetem Vladimir Metani.

NENI 11

Fitimet e realizuara nga Shoqëria nëpërmjet aktivitetit të saj pas shlyerjes së detyrimeve do të mbeten në favor të ortakut të vetem që është Z.Vladimir Metani, i cili ka te drejtë që ti përdorë ato në favor të interesave vetiake e të shoqërisë.

NENI 12

Shoqëria pasi paguan taksat,tatimet dhe cdo detyrim tjeter ligjor në lidhje me aktivitetin e objektit të saj,ka të drejtë që të krijojë fonde rezerve dhe fonde të vecanta financimi me qëllim të shtimit të kapitalit themeltar me kuota,me mjete ose të ripërtë-ritjes së mjeteve në natyrë.

NENI 13

Fondi themeltar i shoqërisë nga mjetet(kuotat) e investuar

të ortakut si dhe nga mjetet(kuotat) e investuara nga persona të tretë brenda dhe jashtë Shqipërisë.Për mjetet e investuara në fondin themeltar ortaku ka te drejte që të shtojë kete fond brenda mundësive të mjeteve të lira që i krijohen nga aktiviteti i Shoqërisë ose nga burime të tjera të ligjëshme.

NENI 14

Shoqëria për të ardharat dhe shpenzimet që kryen është e detyruarë ti pasqyrojë në bilancin e saj gjashtë major dhe atë vjetor duke ju përgjigjur konkretisht detyrimeve ligjore.

IV. ORGANI DREJTUES I SHOQËRISË

NENI 15

Organi i vetem drejtues dhe vendimor i Shoqërisë është administratori i saj,ortaku i vetem Z.Vladimir Metani, i cili gjykon për:

- Problemet e bilancit
- Ndryshimet në Statut
- Rritjen e pakësimin e kapitalit baze.
- Rritja dhe pakësimi i fondit rezerve,zgjerimi dhe pakësimi i programit vjetor të shoqërisë,zgjerimi dhe pakësimi i aktivitetit të saj.

NENI 16

Administrator i Shoqërisë është Z.Vladimir Metani,por në baze të Ligjit "Për Shoqëritë Tregetare" ajo ka te drejte që të caktojë administrator dhe një person tjeter jo ortak.

NENI 17

Me miratimin e ortakut të vetem,numuri i ortakeve mund të shtohet.Ortaku i ri duhet të investojë mjete(kuota) të barabarta ose sipas marrveshjes edhe në përmasa të tjera.

NENI 18

Shoqëria mund të emërojë një ose disa ekspert kontabel të autorizuar sipas kushteve të përcaktuara në nenin 59 të Ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992"Për Shoqëritë Tregtare".

NENI 19

Shoqëria ka të drejtë që të marre në punë punëtorë e specialistë me kontrate pune.marrdheniet e punës të Shoqërisë rregullohen nëpërmjet kontratës në punës dhe në baze te K.Punës.

NENI 20

Shoqëria ka një kohëzgjatje prej mbi 10 vjetesh.

%%

**NENI [illegible]**

Shoqëria mund të pushojë në funksionari në keto raste:

Paligjshmëria e krijimit të shoqërisë"

Kur ortaku i vetem tërheq mjetet e veta me qëllim mbyllje të aktivitetit të shoqërisë.

Kur hapet procedur e likujdimit kur ajo falimenton.

Kur shoqëria shndrohet në një shoqëri tjeter sipas rregullave të përcaktuara në ligj.

Ky akt-themelimi u përpilua në kater kopje me të njëjten fuqi ligjore dhe u nënshkrua rregullisht nga themeluesi i Shoqërisë ortaku i vetem Z.Vladimir Metani.

ORTAKU I VETEM
( Vladimir Metani )

REPUBLIKA E SHQIPERISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
Nr. 2857 rep.
Nr. 724 kol.

**V E R T E T I M**

Vertetoj se sot me daten 3.06.1996(nentedhjete e gjasht para meje Noteres Publike u paraqit personalisht Z.Vladimir Metani, i panjohur prej meje,madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar për identitetin e të cilit u sigurova me leter njoftimin personal,i cili më deklaroi se ka krijuar një shoqëri tregëtare si më sipër.Me vullnetin e tij të lirë e nenshkroi aktin e themelimit në praninë time.U.Ë Noterja e verteoj dhe nënshkruaj sipas ligjit.

N O T E R E

NOTERE
VIOLETA ISARAJ
TIRANE

## STATUT

## SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

## "DESARET KOMPANY"SH.P.K.

Në mbështetje të nenit 3 dhe të nenit 37 të Ligjit Nr. 7638 date 18.11.1992"Për Shoqëritë Tregatre",unë Vladimir Metani në mbështetje të aktit të themelimit hartoj Statutin e Shoqërisë Tregetare me përgjegjësi të kufizuar në pronësi private të emërtuar "DESARET KOMPANY"SHPK.

### I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

**NENI 1**

Shoqëria Tregetare me përgjegjësi të kufizuar në pronësi private të emërtuar "DESARET KOMPANY"SHPK,Tiranë,në kete Statut në përputhje me aktin e themelimit të Shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar rregullon pozitën juridike të ortakut të vetem dhe të punonjësve të shoqërisë.

**NENI 2**

Shoqëria është krijuar mbi bazën e aktit të themelimit dhe statutitit saj.Mbi kete baze ajo ka statusin e personit juridik

**NENI 3**

Selia e Shoqërisë është në qytetin e Tiranës me adresë Rruga "Qemal Stafa",pranë Pll.186/1.Ajo mund të ngrejë filiale në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë saj.Selia e Shoqërisë mund të ndryshojë.

**NENI 4**

Shoqëria ka vulën dhe intestimin e saj të përcaktuar sipas vullnetit të administratorit të saj në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### II. OBJEKTI I VEPRIMTARISË

**NENI 5**

Objekti i veprimtarisë të kesaj Shoqërië do të jetë:

Ndërtime dhe punime të ndryshme dheu,muratarë beton arme shembjesh,ndertime civile,industriale,turistike,bujqësore,restaurimi, instalime,ujësjellesa,kanalizime,ndertime dhe riparim rrugësh dhe urash,import eksport materiale ndertimi,prodhime materiale të ndryshme ndertimi etje,si dhe prodhim e përpunime druri,import-eksport.

NENI 6

Shoqëria e ushtron veprimtarinë e saj duke u mbeshtetur në likujditet, sigurinë dhe rentabilitetin e veprimtarisë.

Shoqëria i ka të gjitha autorizimet në qarkullimin juridik me persona të tretë.

NENI 7

Veprimtaria e Shoqërisë, emërtimi i saj dhe Selia të përcaktuara në kete Statut mund të ndryshojnë vetem me vendim të administratorit të Shoqërisë ortakut të vetem Z.Vladimir Metani.

III. MJETET E SHOQËRISË

NENI 8

Kapitali themeltar i Shoqërisë është caktuar në shumën 100000(njëqinte mijë lekë), shume e cila është derdhur nga ortaku i vetem Z.Vladimir Metani .

Kapitali është tërësisht dhe lirisht i transferueshëm në rrugë trashegimie.

Ortaku i vetem nuk përgjigjet me pasurinë e tij private për detyrimet e shoqërisë në raport me të tretet ose për gabimet e një ortaku tjeter të mundëshëm në rast se do të pranohet nga themeluesi i kesaj shoqërie.

NENI 9

Shoqëria ka të drejtë që të hyjë në marrdhenie me Bankat e Shqipëtare dhe të hapja, të celë llogari përkatese të kërkojë sipas nevojave kreditim prej tyre dhe të kryeje operacione bankare.

NENI 10

Shoqëria ka të drejtë që kundrejt pagesës të aktivizojë specialistë të ndryshëm për nevojat e saj.

Gjithashtu ajo ka te drejtë që të aktivizojë dhe të punësojë punëtorë dhe specialistë me kontrate pune duke u mbeshtetur në Kodin e Punës.

NENI 11

Shoqëria është pronare dhe përdoruese e gjithë pasurisë së saj si kapital fillestar dhe atij në natyrë.Ajo ka të drejtë që të krijojë në baze te ligjit fonde të tjera të vecanta financimi për zhvillimin dhe rritjen e aktivitetit të saj.

%%

NENI 12

Veprimtaria ekonomike e financiare mbyllet në datem 31 dhjeto të cdo viti.Administratori dhe specialisti i ngarkuar prej tij nxjerrin bilancin me te ardharat dhe shpenzimet duke llogaritur fitimin përkates,i cili kalon tërësisht në fafor të orkaat të vetem.

IV. ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

NENI 13

Organi i vetem drejtues i shoqërise eshte ortaku i vetem Administratori i shoqërise z.Vladimir Metani.Ai gjykon dhe vendon për këto probleme:

-Problemet e bilan cit vjetor te shoqërise
-Ndryshimet që mund te bëhen ne statat.
-Rritjen dhe pakësimin e kapitalit baze,brenda kufijve.
-Rritjen dhe pakësimin e fondit rezerve.
-Miratimin dhe ndryshimin e programit vjetor te shoqërise.
-Zgjerimin dhe pakësimin e aktivitetit te shoqërise

NENI 14

Shoqëria administrohet nga Administratori që është ortaku i vetëm, ose nga nje person tjeter i ngarkuar prej tij.

NENI 15

Në rast se ne te ardhmen do te caktohet nje administrator ortak, ai do te kete te gjitha kompetencat në maredhenje me te tre tet në emër te shoqërise sipas aktit te delegimit që i lëshon administratori me përjashtim te kompetencave që ligji i jep shprehimisht ortakut te vetëm si themelues i shoqërise.
Te drejtat dhe detyrat e administratorit në rast se ai do te caktohet me nje akt te mëvonshëm, do te jene atà te përcaktuara në Nenin 16 te ligjit Nr 7638 "Për Shoqërite Tregtare".

V-MAREDHËNJET E PUNES

NENI 16

Maredhenjet e punes në shoqëri rregullohen në përputhje me kontraten e punës,Aktin e Themelimit te shoqërise,Statutin dhe legjislacionin Shqiptar në fuqi.

%%%%%%%%%%%

NENI 17

Në kontratën e punës rregullohen këto çështje:
Kushtet dhe mënyra e ndërtimit te marrëdhenjeve te punës
Fillimi i punës së punonjësit dhe caktimi i tij në vendin e punës
Koha e punës,pushimit,pagesat;kushtet e punës,te drejtat dhe
detyrimet dhe përgjegjësitë.
Pushimi i marrëdhenjeve te punës

NENI 18

Punonjësit për punën e tyre që bëjnë marrin pagën e caktuar në përputhje me kontratën e punës,pamvaresisht nga rezultatet ekonomike që arrihen në Shoqëri.

Në kontratën e punës,caktohen,paga e punës,shpërblimi,si dhe detyrimet e Shoqërise ndaj tij.

NENI 19

Punonjësi ështe personalisht përgjegjës për kryerjen e detyrave te marra përsipër sipas kontratës së punës,duke u përgjigjur për ruajtjen e sekretit te aktivitetit te Shoqërise dhe te atyre te dhenave që janë sekrete pune.

VI-KOHE GJATJA E AKTIVITETIT TE SHOQERISE

NENI 20

Kohezgjatja e zhvillimit te aktivitetit te Shoqërise përcaktohet për nje periudhe kohe prej 10 vjet me te drejte te rinovimit te këtij afati.

NENI 21

Shoqëria mund te pushoje se funksionuari në këto raste:
-Paligjshmërise e krijimit te Shoqërise
-Kur Ortaku terheq mjetet e veta me qëllim mbylljen e aktivitetit te shoqërise.
-Kur Shoqëria shndrrohet për arsye te ndryshme në nje shoqëri te tipit tjeter,sipas rregullave te përcaktuara në ligj.
-Kur hapet procedura e likuidimit përkatesisht e falimentos.

NENI 22

Kur pushon veprimtarinë ovet shoqëria ështe e detyruar te bëje pagesat karshi kreditoreve te mundeshëm si dhe te njoftoje personelin që ka te punesuar tre muaj më pare.
Shoqëria mund te pushoje se ekzistuari dhe për shkaqe te tjera

te përligjara që do te gjykohen nga Themeluesi i saj.

NENI 23

Për rregullat e tjera që nuk janë parashikuar në këte statut do te veprohet sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe në veçanti te Ligjit Nr.7638 Date 19/11/1992 "Për Shoqërite Tregtare"

VII-DISPOZITAT E FUNDIT

NENI 24

Shoqëria fillon te fitoje zotesine e saj për te vepruar me rregjistrimin e saj në Gjykaten e rrethit Tirane dhe me marjen e licenses për ushtrimin e aktivitetit në organet kompetente.

NENI 25

Ndryshimet dhe plotesimet e këtij statuti bëhen me te njejten menyre dhe procedure me te cilën nxirret statuti.

NENI 26

Pasuria e shoqërise mund te sigurohet në I N S I G sipas legjislacionit në fuqi.

NENI 27

Cdo mosmarreveshje që mund te lindo gjate aktivitetit te Shoqërise,do te zgjidhet sipas rastit nga Gjykata e Rrethit.
Ky statut hyn ne fuqi diten e firmosjes nga Ortaku i vetëm dhe regjistrimit te tij në organet përkatese.

Ky Statut u përpilua në kater(4) kopje dhe u firmos rregullisht nga Themeluesi i Shoqërise,ortaku i vetëm z.Vladimir Metani.

O R T A K U I V E T Ë M

(VLADIMIR METANI)

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr 2258 Prot
Nr 725 Rep

V E R T E T I M

Vertetoj se sot më daten 3.06.1996(nëntedhjetegjashte) para meje Noteres Publike në qytetin e Tiranës, u paraqit personalisht z.Vladimir Metani,i njohur prej meje,madhor me zotesi te plote juridike për te vepruar për identitetin e te cilit u sigurova